




Administrimi i sistemit të drejtësisë nga Këshillat

Raporti i monitorimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial në vitin 2021



Autorët: Mirvet Thaqi dhe Lavdim Makshana

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Qershor, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	4
2. Miratimi i legjislacionit sekondar në KGjK.....	6
3. Llogaridhënia në sistemin gjyqësor dhe mekanizmat e kontrollit	8
4. Transparenca e KGjK dhe sistemit gjyqësor	8
5. Mos themelimi i degëve të gjykatave vështirëson qasjen efikase në drejtësi	9
6. (Mos)përmbushja e planit të punës dhe realizimi jo i plotë i vlerësimit të performancës ...	10
8. Vonesat në zgjedhjen e kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës nga KGjK.....	11
9. Akuzat për mos transparencë në dekretimin e 23 gjyqtarëve	12
10. Skandali i përgjimeve të ish-anëtarit Driton Muharremi dhe reagimi i KGjK-së.....	13
11. (Mos) Disiplinimi i gjykatësve dhe stafit serb që bojkotuan punën në Gjykatën Themelore në Mitrovicë	14
12. Risitë në KGJK pas zgjedhjes së kryesuesit të ri	15
13. Miratimi i legjislacionit sekondar nga KPK	18
14. Llogaridhënia dhe integriteti në Sistemin Prokurorial.....	18
15. Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit prokurorial.....	19
16. (Pa)ligjshmëria në avancimet dhe transferimet e prokurorëve	21
17. Zgjedhjet dhe kandidaturat e kundërligjshme në KPK	22
18. Vendimi skandaloz i KPK-së për trajnimin e prokurores tre muaj para pensionimit.....	23
19. Skandali i përgjimeve dhe standardet e dyfishta të KPK.....	23
19.1 Dorëheqja e prokurores së përfshirë në përgjime	23
19.2 Përfshirja e Lumezit në skandalin e përgjimeve dhe mos reagimi i KPK	24
20. Dështimi për ta përmbushur planin e punës për vitin 2021	25

1. Përmbledhja ekzekutive

Gjatë vitit 2021 Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) kanë ndjekur trajektore të ndryshme drejt përmbushjes së objektivave për një sistem të drejtësisë me integritet, transparencë dhe llogaridhënie.

Për arritjen e këtyre objektivave KGJK ka ndërmarrë një sërë hapash pozitivë, duke filluar nga transmetimi online i takimeve të saj në *Facebook*, publikimi i pothuajse 97% të vendimeve të miratuara, udhëheqja me transparencë të plotë dhe me integritet e procesit të rekrutimit të gjykatësve të rinj, publikimi i vendimeve të autoriteteve kompetente për refuzimin e ankesave disiplinore të parashtruara nga personat fizikë dhe juridikë ndaj gjyqtarëve, etj. Regres në kuptim të transparencës ka treguar KPK, e cila afro gjysmën e vendimeve të miratuara nuk i ka publikuar në faqen e saj zyrtare, duke vazhduar të mos publikojë në tërësi vendimet e miratuara edhe në gjuhën serbe. Po ashtu, qasje jo transparente KPK ka treguar edhe kur ka injoruar ofertën e Ambasadës Britanike për mbështetje të procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit. Sa i përket llogaridhënies, masa më e rëndë disiplinore që KGJK ka shqiptuar gjatë vitit të kaluar ka qenë degradimi, që ishte shqiptuar ndaj ish-anëtarit të KGJK-së Driton Muharremi, si pasojë e përfshirjes së tij në një aferë të përgjimeve, derisa tek KPK masa më e rëndë disiplinore e shqiptuar ka qenë vërejtja jo publike me shkrim, çka paraqet një qasje “*amnistuese*” të Këshillit në disiplinimin e prokurorëve që përfshihen në shkelje disiplinore.

KPK nuk ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ish-Kryeprokurorit të Shtetit Aleksandër Lumezi, ndonëse emri i tij ishte apostrofuuar në përgjimet e dala në publik, duke përçarur mesazhin e paprekshmërisë së figurave të caktuara në sistemin prokurorial. Zgjedhja me shkelje ligjore e Jetish Malokut në krye të KPK-së, në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ka mundësuar riciklimin e tij në këtë pozitë, duke i siguruar atij një mandat 10 vjeçar.

Të dy Këshillat gjatë vitit 2021 kanë dështuar që të përmbushin obligimet ligjore për miratimin e legjislacionit sekondar dhe realizimin e plotë të planeve të tyre të punës, që për pasojë ka sjellë ngeljen e një sërë akteve nënligjore të pa miratuara. KGJK kishte treguar progres në ushtrimin e kontrollit ndaj krerëve të gjykatave përmes mekanizmit të raportimit të tyre para anëtarëve të saj, derisa KPK nuk kishte ftuar fare Kryeprokurorët që të raportojnë, por ishte mjaftuar me dërgimin e raporteve me shkrim. Gjatë vitit 2021 KGJK nuk kishte arritur që të bëjë vlerësimin e performancës për 1/3 e gjyqtarëve me mandat të përhershëm sipas metodës *random*, derisa KPK gjatë kësaj periudhe e kishte realizuar në tërësi këtë proces.

Edhe gjatë vitit 2021 KPK kishte vazhduar praktikën e kundërligjshme të avancimit të prokurorëve në emër të transferimit. Gjatë këtij viti, KPK me një vendim të paarsyeshëm e kishte dërguar për trajnim të detyrueshëm prokuroren Ferdane Sylejmani, vetëm tre muaj para pensionimit, vendim i cili i përveç se është i palogjikshëm, dëmton edhe resurset shtetërore.

Edhe gjatë vitit të kaluar, KGJK-ja ka vazhduar me praktikën e mirë instaluar të konsultimeve publike. Për këtë, IKD ka rekomanduar formalizimin e këtyre procedurave.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës



2. Miratimi i legjislacionit sekondar në KGJK

Miratimi i akteve nënligjore përbën një nga kompetencat e rëndësishme të KGJK-së për të garantuar administrimin efikas të drejtësisë. Gjatë vitit 2021 KGJK ka miratuar gjithsej gjashtë rregullore dhe ka bërë një ndryshim/plotësim të një rregulloreje bazë¹ (e cila po ashtu ishte miratuar në vitin 2021)², tre udhëzime administrative (UA) dhe një udhëzues.

Ndonëse në këtë aspekt Këshilli ka shënuar progres krahasuar me vitin 2020³, ky institucion nuk ka arritur që të miratojë aktet normative të parapara me Planin e tij të Punës për vitin 2021, si Rregulloren për trajtim të kërkesave për qasje në dokumente publike, atë për normën e gjyqtarëve individualë, për Organizimin e Sekretariatit, etj.⁴ Një fenomen negativ që e ka shoqëruar KGJK-në edhe gjatë vitit 2021 ka qenë mos miratimi i akteve nënligjore që derivojnë nga Ligji për KGJK-në dhe Ligji për Gjykatat,⁵ çka paraqet një mos respektim të ligjit që vjen si pasojë e mungesës së efikasitetit dhe mungesës të planifikimit të duhur brenda vet KGJK-së dhe komisioneve të saj.

Sa i përket Kodit të Etikës për Staf Administrativ, KGJK ka theksuar se është në fuqi Kodi i Mirësjelljes për Personelin e Administratës Gjyqësore, i zbatueshëm që nga viti 2012. Lidhur me këtë çështje, KGJK deklarim të ndryshëm kishte dhënë për IKD-në në raportin “*Cenimi i Integritetit të Këshillave nga Këshillat*”, ku theksonte se “*për këtë fushë vlen Kodi i Etikës i miratuar nga Ministria e Administratës Publike ndërsa KGJK është duke e hartuar edhe një draft që plotëson këtë Kod*”.⁶ Sa i përket rregullores për arsimim të vazhdueshëm të gjyqtarëve, sipas KGJK-së, nxjerrja e një akti të tillë është e panevojshme pasi kjo fushë rregullohet me Rregulloren nr.06/2017 për trajnimin e gjyqtarëve dhe e plotësuar me Rregulloren nr.06/2019. Përgjegjësitë e komisioneve të përhershme, sipas KGJK-së janë të rregulluara me Rregulloren nr.03/2020. E panevojshme, sipas KGJK-së është edhe nxjerrja e një akti nënligjor për themelimin e degëve të reja, pasi sipas tyre kjo çështje rregullohet me Ligjin për Gjykatat.⁷ Po ashtu, KGJK ka theksuar se është e angazhuar maksimalisht në përmbushjen e obligimeve

¹Rregullorja Nr.01/2021, Nr.02/2021, Nr.03/2021, Nr.04/2021, Nr.05/2021 dhe Nr.06/2021. Udhëzuesi për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve; UA nr.01/2021, UA nr.02/2021 dhe UA nr.03/2021.

² **Shënim:** Rregullorja nr.01/2021 për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve ishte miratuar nga KGJK më 26 janar 2021, ndërsa dy muaj më pas ishte dërguar në plotësim/ndryshim. Më 15 prill 2021, Këshilli kishte miratuar Rregulloren nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.01/2021.

³ Bajraktari, L; Gashi, L: “*Cenimi i integritetit të Këshillave nga Këshillat*”. Prishtinë. Prill. 2021. Fq. 9-10. (Shih linkun <https://kli-ks.org/cenimi-i-integritetit-te-keshillave-nga-keshillat/>). (Qasur për herë të fundit më 13 maj 2022).

⁴ “*Plani i Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2021*”. Fq.4, 5 dhe 12 (Shih linkun https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/95135_KGJK_Plani_Punes_2021.pdf). Qasur për herë të fundit më 9 maj 2022).

⁵ **Shënim:** Me Ligjin për KGJK dhe Ligjin për Gjykatat parashihej që deri në janar të vitit 2020 të miratoheshin këto akte normative: Kodi i Etikës për Gjyqtarë Porotë, Kodi i Etikës për Staf Administrativ, Rregullorja për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisioneve të Përhershme të KGJK-së (Neni 16.4. i Ligjit për KGJK), Rregullorja për strukturën organizative dhe Funksionimin e SKGJK-së, Rregullorja për Administratorët e Gjykatave; Rregullorja për Shqyrtimin e Kërkesave për Themelimin e Degëve të Reja të Gjykatave; Rregullorja për Veprimtaritë Profesionale të Gjyqtarëve dhe Rregulloren për Arsimimin e Vazhdueshëm ligjor.

⁶ Bajraktari, L; Gashi, L: “*Cenimi i integritetit të Këshillave nga Këshillat*”. Prishtinë. Prill. 2021. Fq. 9-10. (Shih linkun <https://kli-ks.org/cenimi-i-integritetit-te-keshillave-nga-keshillat/>). (Qasur për herë të fundit më 1 qershor 2022).

⁷ Përgjigje nga KGJK për IKD. 1 qershor 2022.

ligjore të saj, por se pasojat nga pandemia COVID/19 kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e çdo aktiviteti tek ky institucion. Këshilli ka njoftuar se ka hartuar Draft Rregulloren për Strukturën Organizative dhe Funksonimin e Sekretariatit të Këshillit e cila parashihet që të miratohet gjatë vitit 2022.⁸

Lidhur me këtë, IKD rithekson se rregulloret që citon KGjK janë nxjerrë në bazë të një ligji tashmë të shfuqizuar. Pra, ajo bazë ligjore tashmë nuk ekziston. Në anën tjetër, sipas nenit 42.3 të i Ligjit Nr.06/L055 për KGJK-në përcaktohet qartë se “*Deri në miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë Ligj, të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli vazhdojnë të zbatohen me kusht që të mos jenë në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji*”, derisa paragrafi 1 i po këtij neni përcakton se “*Aktet nënligjore të përcaktuara në këtë Ligj do të nxirren në afat prej një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji*”. Pra, sipas ligjit të ri për KGJK-në, rregulloret që përmend Këshilli duhet të zbatohen vetëm deri në momentin e miratimit të akteve të tjera, të cilat sipas ligjit, duhet të miratohen në periudhë kohore prej një (1) viti që nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ndërsa, domosdoshmërinë e miratimit të Rregulloreve për themelimin e degëve të reja dhe asaj për veprimtarinë profesionale të gjyqtarëve, IKD e ka argumentuar qartë në raportin e saj analitik “*Cenimi i Integritetit të Këshillave nga Këshillat*”.⁹

Përkundër rekomandimeve të dhëna nga IKD lidhur me çështjen e ndryshimit të shpeshtë të rregulloreve, një praktikë e tillë është hasur edhe gjatë vitit 2021. Dy muaj pas miratimit të Rregullores për vlerësim të performancës, Këshilli kishte marrë vendim që të njëjtën ta dërgojë në plotësim/ndryshim. Kjo praktikë e ndryshimit të shpeshtë të rregulloreve mund të ketë ndikim negativ dhe të cenojë sigurinë juridike të akterëve dhe proceseve të rëndësishme të cilat udhëhiqen nga KGjK.¹⁰ Lidhur me këtë, IKD vlerëson se procesit të hartimit të akteve normative duhet t’i paraprijë një analizë e mirëfilltë, duke etabluar diskutime shteruese dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim që të ndërtohen rregullore të qarta të cilat rregullojnë në tërësi fusha të caktuara, që të pamundësohen situatat e tilla kur rregulloret ndryshohen brenda një afati të shkurtër.

Për t’u vlerësuar lart është praktika pozitive e aplikuar nga KGjK për përfshirjen e publikut në fazën e draftimit të akteve normative, mirëpo të cilës i mungon formalizimi me akt nënligjor të veçantë. KGJK ka ndërmarrë hapa në këtë drejtim dhe kërkohet që kjo rregullore të miratohet brenda vitit 2022.

⁸ Përgjigje nga KGjK për IKD. 7 prill 2022.

⁹ Bajraktari, L; Gashi, L: “*Cenimi i integritetit të Këshillave nga Këshillat*”. Prishtinë. Prill. 2021. Fq. 10-11. (Shih linkun <https://kli-ks.org/cenimi-i-integritetit-te-keshillave-nga-keshillat/>). (Qasur për herë të fundit më 1 qershor 2022).

¹⁰ Venice Commission. “*EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW – Rule of Law Check list*”. 18 mars 2016. Fq.16. (Stability and consistency of law). Shih linkun ([https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)007-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)007-e)). (Qasur për herë të fundit më 24 maj 2022).

3. Llogaridhënia në sistemin gjyqësor dhe mekanizmat e kontrollit

Gjatë vitit 2021, KGJK ka marrë 16 vendime disiplinore, prej nga masa më e rëndë e shqiptuar ka qenë degradimi dhe transferimi i përhershëm i një gjykatësi,¹¹ derisa në 6 vendime gjykatësit nuk janë gjetur përgjegjës.¹² Për një subjekt hetimor ishte pushuar procedura disiplinore për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të shkeljes disiplinore.¹³

KGJK dhe Sekretariati gjatë vitit 2021 kanë përmbushur me sukses obligimin për publikimin e raportit vjetor për vitin 2020, Raportin Statistikor të Gjykatave për vitin 2020 si dhe Raportin Statistikor të Gjykatave për tre mujorin e parë dhe për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021. Vlen të theksohet se këto raporte, krahas të dhënave statistikore që ofrojnë, nuk sqarojnë asgjë më shumë dhe qasja analitike dhe krahasuese e tyre mungon. Të dhënat numerike ashtu siç janë prezantuar në këto raporte nuk i japin mundësi publikut që të dijë nëse numri i lëndëve që janë në punë në kuadër të sistemit gjyqësor është i menaxhueshëm nga vet gjyqësori apo jo.

Në aspektin e ngritjes së llogaridhënies në sistemin gjyqësor ndikim pozitiv ka pasur fakti se kryetarët e gjykatave janë ftuar që të raportojnë para Këshillit për punën e gjykatave që kanë udhëhequr, krahas dërgimit të raporteve tre mujore dhe vjetore me shkrim. Kjo paraqet progres në raport me vitin e kaluar, ku kryetarët e gjykatave ndonëse i kishin dorëzuar me shkrim raportet e tyre tre mujore, asnjë nga ta nuk ishte ftuar për të raportuar në KGJK.¹⁴

4. Transparenca e KGJK dhe sistemit gjyqësor


Qasja në informacione publike në kuadër të sistemit gjyqësor përbën një çështje mjaft të rëndësishme dhe është një nga treguesit e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies kundrejt qytetarëve, shoqërisë civile dhe mediave. Nga 520 kërkesa për informata dhe qasje në dokumente zyrtare të adresuara nga IKD në KGJK dhe gjykatat në Kosovë, janë pranuar 258 përgjigje pozitive apo rreth 50%. Vetëm në KGJK, IKD gjatë kësaj periudhe ka parashtruar 56 kërkesa të tilla, nga të cilat, në 26 raste (46%) ka pranuar përgjigje pozitive, në 5 raste (9%) negative dhe 25 kërkesa (45%) kanë mbetur pa përgjigje.

¹¹ Përgjigje nga KGJK për IKD. 13 janar 2022.

¹² **Shënim:** Gjatë kësaj periudhe Këshilli sipas detyrës zyrtare e ka shqyrtuar dhe vlerësuar çështjen e suspendimit të një gjyqtari në një rast disiplinor dhe me shumicë votash ka vendosur për suspendimin e tij deri në një vendim tjetër të Këshillit.

¹³ Vendimi **KGJK.nr.74/2021**.

¹⁴ Bajraktari, L; Gashi, L: “*Cenimi i integritetit të Këshillave nga Këshillat*”. Prishtinë. Prill. 2021. Fq. 18. (Shih linkun <https://kli-ks.org/cenimi-i-integritetit-te-keshillave-nga-keshillat/>). (Qasur për herë të fundit më 13 maj 2022).



Grafiku 1: Transparenca e KGjK-së dhe gjykatave në kërkesat e IKD gjatë vitit 2021-së

Nga 29 takime të mbajtura nga Këshilli, janë nxjerrë 431 vendime, ndërsa janë publikuar 418 sosh, përfshirë edhe ato disiplinore, apo 97%.¹⁵ KGJK ka vazhduar t’i publikojë vendimet e saj edhe në gjuhën serbe, porse ende mbesin vendime të tilla të cilat nuk janë publikuar edhe në gjuhën serbe.¹⁶

Mungesë të transparencës në raport me publikun KGJK ka treguar me rastin e mbajtjes së takimeve përmes komunikimeve elektronike, ku nga pesë (5) të tilla të realizuara në vitin 2021, nuk ishte bërë publik rendi i ditës e as nuk ishte lëshuar komunikatë për media. Ndërsa, në dy takime të mbajtura me dyer të mbyllura vetëm në njërin prej tyre, konkretisht në takimin 270-të, Këshilli ka lëshuar komunikatë për media me çka edhe ka njoftuar publikun se çfarë është diskutuar në atë takim.

Janë një sërë vendimesh të marra gjatë vitit 2021 nga KGJK të cilat kanë avancuar transparencën e këtij institucioni në raport me publikun, të tilla si transmetimi “online” i takimeve të Këshillit, vendimi për raportim të krerëve të gjykatave në mbledhje të rregullta, publikimi i vendimeve të Autoriteteve Kompetente për refuzimin e ankesave disiplinore të parashtruara nga personat fizikë dhe juridikë ndaj gjyqtarëve, etj.

Përballë këtij progresi të theksuar, sfida që duhen adresuar nga KGJK është trajtimi konform ligjit i të gjitha kërkesave për qasje në dokumente publike.

5. Mos themelimi i degëve të gjykatave vështirëson qasjen efikase në drejtësi

Qytetarët e Fushë Kosovës, Obiliqit, Junikut, Shtimes dhe Hanit të Elezit akoma hasin në vështirësi sa i përket realizimit efikas të së drejtës për qasje të lehtë në drejtësi. Kjo pasi Këshilli, edhe përgjatë vitit 2021, ka dështuar që të përmbushë obligimin ligjor konform nenit 10 të Ligjit për gjykatat, për themelimin e degëve të gjykatave që do t’i trajtonin ekskluzivisht rastet e tyre, pa pasur nevojë që të njëjtit t’u drejtohen gjykatave më të largëta në qytete tjera.

KGJK ka bërë të ditur se është në përfundim e sipër ndërtimi i objektit të ri të gjykatës për komunën e Fushë Kosovës dhe Obiliqit, që pritet të hapet gjatë vitit 2022. Pastaj, në kuadër të kornizës afatmesme të shpenzimeve, sipas Këshillit, është planifikuar edhe projekti i hapjes së

¹⁵ **Shënim:** Vendimet e pa publikuara janë vendime të takimeve të mbyllura të KGJK-së, vendime që kanë të bëjnë me shqiptimin e vërejtjeve jo-publike me shkrim dhe vendime lidhur me kundërshtimet e kandidatëve për kryetar gjykate dhe se nuk publikohen në ueb faqen zyrtare të Këshillit. (Qasur për herë të fundit më 20 prill 2022).

¹⁶ **Shënim:** Të dhënat e fundit lidhur me publikimin e vendimeve janë nxjerrë më 8 prill 2022.

degës në Shtime, ndërsa sa i përket hapjes së degëve të tjera, sipas tyre, kjo kushtëzohet nga mundësitë buxhetore në dispozicion.¹⁷

Pa dyshim që funksionalizimi i këtyre degëve të gjykatave do të lehtësonte qasjen në drejtësi të qytetarëve që u përkasin atyre lokaliteteve dhe do të ndikonte në reduktimin e ngarkesës me lëndë të selive kryesore të gjykatave themelore të cilat ngarkohen me lëndë si pasojë e mos themelimit të këtyre degëve. Për më tepër, kjo do të ndikonte që edhe këto raste të kishin një procedim më efikas dhe brenda afateve të arsyeshme kohore.

Megjithatë, hapja e këtyre degëve të gjykatave është e kushtëzuar edhe nga mjetet buxhetore që Kuvendi i Republikës së Kosovës alokon në adresë të Këshillit sipas Ligjit për Buxhetin, për realizimin e projekteve kapitale. Me buxhetin e vitit 2021 të aprovuar nga Kuvendi¹⁸, ndër të tjera parashihej ndërtimi i objektit të Gjykatës në Fushë Kosovë, derisa për vitin 2022¹⁹, krahas vazhimit të projektit për Gjykatën në Fushë-Kosovë, me buxhetin e miratuar planifikohet edhe ndërtimi i objektit të Gjykatës në Shtime, por jo edhe ndërtimi i objekteve për Gjykatën e Junikut dhe Hanit të Elezit. Për këtë arsye, Ministria e Financave duhet të përfshijë këto investime kapitale në planifikimet buxhetore e më pas dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet që të miratojë ndarjen e këtyre mjeteve financiare në adresë të KGJK për funksionalizimin e të gjitha gjykatave siç parashihet me nenin 10 të Ligjit për Gjykatat, pasi që siç dihet operimi dhe përbushja e mandatit ligjor dhe kushtetues të Këshillit, varet ndër të tjera edhe nga buxheti që këto dy institucione ia vënë në dispozicion këtij institucioni.

6. (Mos)përbushja e planit të punës dhe realizimi jo i plotë i vlerësimit të performancës

KGJK me 30 prill 2021 kishte miratuar planin e punës për vitin 2021. Por, disa nga objektivat të cilat Këshilli i ka përfshirë në këtë dokument mjaft të rëndësishëm ka dështuar që t'i përbushë gjatë kësaj periudhe si: Plani i Veprimit për Zvogëlimin e Lëndëve Civile, UA për shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve, Udhëzuesi themelor i referimit për organet Parahetuese dhe hetuese disiplinore, Udhëzuesit për procesin e konsultimit publik të akteve normative, etj.

Megjithatë, KGJK gjatë kësaj periudhe kishte realizuar shumicën e planifikimeve si: Draftimin e Rregullores për rekrutimin, provimin, emërimin dhe ri emërimin e gjyqtarëve; Draftimin e Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimin te organizuar; Formimin e Grupit Punues për standardizimin e formave të aktgjyqimeve dhe vendimeve gjyqësore, Angazhimet në zbatimin e projektit të audio dhe video incizimit për gjykata (Financuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë) etj.²⁰

Me këtë rast, IKD i rikujton KGJK-së që plani vjetor i punës ka një rëndësi jetike për ngritjen e cilësisë së punës dhe në përgjithësi për ngritjen e cilësisë në administrimin e drejtësisë. Plani

¹⁷ Përgjigje për IKD nga KGJK. 7 prill 2022.

¹⁸ Ligji nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Fq.115-116.

¹⁹ Ligji nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Fq.100-101.

²⁰ "Plani i Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2021". Fq.5,6,10,12. (Shih linkun https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/95135_KGJK_Plani_Punes_2021.pdf). (Qasur për herë të fundit më 22 maj 2022).

vjetor i punës nuk është vetëm një dokument formal i cili vetëm duhet të miratohet, por është një dokument strategjik për të ngritur cilësinë e punës brenda një viti kalendarik. Për këtë arsye, KGJK duhet t'i përmbahet objektivave të përcaktuara në planin vjetor të punës, dhe të përcjellë vazhdimisht zbatimin e planit vjetor të punës.

Gjatë vitit 2021, KGJK kishte dështuar të bëjë vlerësimin e performancës për 1/3 e gjyqtarëve me mandat të përhershëm (44 gjyqtarë), sipas metodës *random*, për periudhën e vlerësimit 2018, 2019 dhe 2020.²¹ Në një përgjigje të dhënë nga KGJK për IKD-në, thuhet se një gjë e tillë nuk është bërë për një arsye, që kishte të bënte me zgjedhjen e përbërjes së re të Komisionit për vlerësimin e performancës i cili kishte filluar punën me 30 prill 2021. Tutje, sipas KGJK-së, ky komision në mungesë të kohës për shkak të angazhimeve të tjera rreth vlerësimit për gjyqtarë të tjerë, për këtë grup të gjyqtarëve ka bërë ndarjen e listës për vlerësim dhe ky proces pritet të përfundojë gjatë muajve të parë të vitit 2022.

8. Vonesat në zgjedhjen e kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës nga KGJK

Zhvillimi i procedurave rekrutuese për pozitat udhëheqëse në kuadër të sistemit gjyqësor nuk është bërë konform afateve të përcaktuara nga vet KGJK-ja. Kjo ka ndikuar që një sërë gjykatash themelore të mbeten për një kohë të gjatë me ushtrues detyre. Në këtë drejtim, KGJK ka qenë e obliguar që më së largu deri më 19 maj 2020 të shpallë konkurs për kryetar të GjTh në Prizren. Po ashtu, më së largu deri më 16 nëntor 2020, KGJK është obliguar që të shpallë konkursin për kryetarë të GjTh në Prishtinë dhe GjTh në Ferizaj. Mirëpo, këto afate të përcaktuara me rregullore nuk janë zbatuar nga ana e Këshillit, kjo pasi që konkursi për kryetar të GjTh në Prizren ishte shpallur më 27 janar 2021, apo 253 ditë pas afatit ligjor. Ngjashëm, 72 ditë pas kalimit të afatit ishte hapur konkursi për të parin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj në Ferizaj.²²

KGJK më 23 qershor 2021, pas gati gjysmë viti me ushtrues detyre kishte zgjedhur kryetaren e GjTH në Prishtinë, znj. Albina Shabani-Rama.²³ Gjithashtu, pas afro tetë (8) muaj me ushtrues detyre, KGJK me 27 shtator 2021 e kishte zgjedhur Mustaf Tahirin, kryetar të GjTH në Ferizaj.²⁴ Ndërsa, përzgjedhja e kryetares së GjTh në Mitrovicë ishte realizuar konform afateve të përcaktuara me rregulloret në fuqi të Këshillit.²⁵ Gjatë vitit 2021 KGJK kishte

²¹ Përgjigje nga KGJK për IKD. 8 shkurt 2022.

²² Rregullore 09/2016 për procedurat e zgjedhjes, vlerësimit, pezullimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës. Neni 3.1 “Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendim shpall pozitën e lire jo më vonë se dyzetepesë (45) dite para skadimit të mandatit të kryetarit apo gjyqtarit mbikëqyrës. Neni 3.2 “Në rast kur pozita e kryetarit mbetet e lirë, konkursi shpallet jo me vone se tridhjetë (30) ditë. Shpallja e vendit të lirë bëhet në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës”.

²³ “Albina Shabani-Rama zgjidhet kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë”. Betimi për Drejtësi, 23 Qershor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/albina-shabani-rama-zgjidhet-kryetare-e-gjykatës-themelore-ne-prishtine/>) (Qasur për herën e fundit më 5 mars 2022).

²⁴ “Mustaf Tahiri zgjedhet kryetar i Gjykatës në Ferizaj, dëshon zgjedhja e kryetarit të Gjykatës së Prizrenit”. Betimi për Drejtësi, 27 shtator 2021 (Shih linkun: [Mustaf Tahiri zgjedhet kryetar i Gjykatës në Ferizaj, dëshon zgjedhja e kryetarit të Gjykatës së Prizrenit - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](https://betimiperdrejtesi.com/mustaf-tahiri-zgjedhet-kryetar-i-gjykatës-në-ferizaj-dëshon-zgjedhja-e-kryetarit-të-gjykatës-së-prizrenit/)). (Qasur së fundi më 21 maj 2022).

²⁵ “Ljiljana Stevanoviq zgjedhet kryetare e Gjykatës Themelore në Mitrovicë”. 1 nëntor 2021 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ljiljana-stevanoviq-zgjedhet-kryetare-e-gjykatës-themelore-ne-mitrovicë/>). (Qasur për herë të fundit më 6 mars 2022).

dështuar me zgjedhjen e kryetarit të GjTH në Prizren, një proces ky i tejzgjatur. Që nga data 4 korrik 2020 e deri më 5 maj 2022, pra për 22 muaj, kjo gjykatë ishte udhëhequr nga një ushtrues detyre. Për më shumë se 8 muaj edhe Apeli ishte udhëhequr me ushtrues detyre. KGJK si arsye për mos përfundimin e shpejtë të këtij procesi kishte përmendur procesin e vlerësimit të performancës të cilit i ishin nënshtruar disa prej kandidatëve.²⁶ Procesi i intervistimit të kandidatëve për këtë pozitë kishte filluar më 4 prill 2022, apo kur kishin kaluar më shumë se 9 muaj që nga shpallja e këtij konkursi.²⁷

KGJK gjatë vitit 2021, kishte shpallur 16 konkurse për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës, në degë të ndryshme të Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës.²⁸ Ndryshe, KGJK në shkurt të vitit 2021, kishte zgjedhur edhe gjyqtarët mbikëqyrës për degët në Graçanicë, Shtërpcë dhe Viti, konkurse këto të shpallura gjatë vitit 2020. Gjatë vitit 2021 KGJK nuk kishte arritur ta zgjedh as gjyqtarin mbikëqyrës të degës në Novobërdë, pasi kandidatja e vetme e cila kishte konkurruar ishte tërhequr nga gara dhe për këtë shkak KGJK me 1 nëntor 2021 kishte vendosur të rishpallë konkursin. Megjithatë, shumë prej degëve të gjykatave themelore, që nga shpallja e konkursit e deri tek zgjedhja e gjyqtarit mbikëqyrës kishin mbetur pa udhëheqës për më shumë se gjashtë muaj, e që vonesat në plotësimin e pozitave të tilla kanë rrezikuar funksionimin normal të këtyre degëve. Duke marrë parasysh rëndësinë që ka pozita e kryetarit të gjykatës dhe ajo e gjyqtarit mbikëqyrës në administrimin efektiv, efikas dhe të ligjshëm të gjykatës dhe efikasitetin e gjykatës lidhur me kryerjen me kohë të lëndëve gjyqësore, IKD thekson domosdoshmërinë që Këshilli vazhdimisht të kujdeset që këto pozita në asnjë rast të mos mbeten vakante, por të plotësohen brenda afateve ligjore.

9. Akuzat për mos transparencë në dekretimin e 23 gjyqtarëve

Ndonëse konkursi për rekrutim nga KGJK ishte shpallur për 27 pozita më 31 dhjetor 2018, nga 27 kandidatët e propozuar për dekretim tek Presidenti i Republikës së Kosovës, vetëm 23 sosh ishin dekretuar. I tërë ky proces, që nga shpallja publike e konkursit e deri në dekretimin e gjykatësve të rinj, ka zgjatur plot dy vjet e 25 ditë.²⁹ Dekretimi i këtyre gjyqtarëve ishte bërë 5 muaj pas propozimit të KGJK, në kundërshtim me afatin ligjor i cili rrjedh sipas Nenit 22 të Ligjit për KGJK.³⁰

²⁶ Përgjigje nga KGJK për IKD. 22.12.2021.

²⁷ “Një kandidat tërhiqet nga gara për kryetar të Apelit, për pesë të tjerë KGJK përfundon intervistat”, Betimi për Drejtësi, 4 prill 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nje-kandidat-terhiqet-nga-gara-per-kryetar-te-apelit-per-pese-te-tjere-kgjk-perfundon-intervistat/>). (Qasur për herë të fundit më 12 maj 2022).

²⁸ **Sqarim:** Këto konkurse ishin shpallur për degën në Suharekë, Dragash, Lipjan, Istog, Klinë, Deçan, Skenderaj, Vushtrri, Rahovec, Malishevë, Novobërdë, Podujevë, Gillogoc, Kaçanik, Leposaviq dhe Zubin Potok. Nga këto 16 konkurse, KGJK për 13 prej tyre kishte arritur ti plotësonte këto pozita me gjyqtarë mbikëqyrës të rinj, ndërsa për degën në Leposaviq dhe Zubin Potok, KGJK nuk kishte arritur ti emërojë gjyqtarët mbikëqyrës për këto pozita gjatë vitit 2021. Këto tri pozita udhëheqëse ishin plotësuar nga Këshilli më 24 shkurt 2022.

²⁹ **Shënim:** KGJK më 31 dhjetor 2018 kishte shpallur Konkurs Publik për rekrutimin e 27 gjyqtarëve në nivel të gjykatave themelore. Ndërsa, lista përfundimtare e kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatat Themelore ishte publikuar gati 19 muaj më vonë, më 27 korrik 2020, pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të ankesave nga ana e Komisionit për Rishqyrtim të Këshillit. Propozimi i këtyre kandidatëve tek Presidenti i Republikës së Kosovës për emërim si gjyqtar me mandat fillestar ishte bërë nga KGJK në mbledhjen e mbajtur më 6 gusht 2020.

³⁰ Ligji për KGJK. Neni 22.2 “Presidenti, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për emërimin në detyrën e gjyqtarit të kandidatit të propozuar nga Këshilli..”.

Krahas kësaj, ky proces ishte përcjellë me mungesë të theksuar të transparencës, shqetësime këto të ngritura edhe nga vet anëtarët e KGJK-së. Ish-anëtari i KGJK-së Driton Muharremi dhe anëtari Avni Mehmeti kanë qenë më të zëshmit sa i përket jo transparencës së këtij procesi. Muharremi aludonte se në mesin e këtyre kandidatëve kishte persona me të kaluar kriminale³¹, derisa Mehmeti deklaronte se Këshilli ndodhej në terr informativ për këtë çështje, e se atyre nuk u ishte lejuar qasje në dosjet e kandidatëve të rekomanduar për dekretim, duke i vënë ata në lajthitje.³² Mungesa e transparencës e cila e kishte shoqëruar një proces kaq të rëndësishëm si ai i dekretimit të gjykatësve të rinj, qoftë në raport me publikun ashtu edhe me vet anëtarët e Këshillit, dërgon një mesazh negativ dhe minon besimin e publikut në proceset që Këshilli i udhëheq dhe vendimet që merr. Për më tepër, publiku asnjëherë nuk është informuar nga KGJK për arsyet e vërteta se pse nga 27 kandidatë për gjyqtarë të propozuar për dekretim, janë dekretuar vetëm 23 prej tyre, ngase edhe diskutimi në mes anëtarëve të Këshillit për këtë çështje ishte bërë me dyer të mbyllura dhe ajo çka ishte diskutuar nuk ishte përfshirë në njoftimin për media.³³

10. Skandali i përgjimeve të ish-anëtarit Driton Muharremi dhe reagimi i KGJK-së

Përfshirja e ish-anëtarit të Këshillit Gjyqësor dhe ish-gjyqtarit Driton Muharremi në përgjimet e publikuara nga mediumi online “shqip.com” në korrik të vitit 2021 përbën një skandal të madh me të cilin u ballafaqua gjyqësori në vitin e kaluar.³⁴ Pas kësaj afere, Muharremi ishte dorëhequr nga pozita e anëtarit të Këshillit.³⁵

KGJK nuk kishte qëndruar indiferente ndaj këtyre përgjimeve, ashtu që me 5 gusht 2021 kishte themeluar një komision “ad hoc” për shqyrtimin e përgjegjësisë disiplinore. KGJK e kishte gjetur përgjegjës Muharremin për shkelje disiplinore, duke i shqiptuar si sanksion disiplinor Transferimin e përhershëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i

³¹ “Ngritën dyshime lidhur me transparencën e avancimeve të gjyqtarëve në Departamentet Speciale dhe në Apel”, Betimi për Drejtësi, 21 dhjetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ngriten-dyshime-lidhur-me-transparencen-e-avancimeve-te-gjyqtareve-ne-departamentet-speciale-dhe-ne-apel/>). (Qasur për herë të fundit më 17 maj 2022).

³² “Anëtarët e KGJK-së kërkojnë të dinë pse nuk janë dekretuar të gjithë gjyqtarët nga presidentja, dyshime se ishin propozuar kandidat më të kaluar kriminale”, Betimi për Drejtësi, 26 janar 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/anetaret-e-kgjk-se-kerkojne-te-dine-pse-nuk-jane-dekretuar-te-gjithe-gjyqtaret-nga-presidentja-dyshime-se-ishin-propozuar-kandidat-me-te-kaluar-kriminale/>). (Qasur për herë të fundit më 17 maj 2022).

³³ “KGJK diskuton prapa dyerve të mbyllura mos dekretimin nga presidentja të katër kandidatëve për gjyqtarë”. Betimi për Drejtësi, 27 janar 2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-diskuton-prapa-dyerve-te-mbyllura-mos-dekretimin-nga-presidentja-te-kater-kandidateve-per-gjyqtare/>). (Qasur për herë të fundit më 10 maj 2022).

³⁴ “Ekskluzive: “Çka ki te Lumezi fol me mu” – Shkeljet dhe fuqia e Driton Muharremit në sistemin prokurorial të Kosovës”. Shqip.com(<https://shqip.com/shenjester/ekskluzive-cka-ki-te-lumezi-fol-me-mu-shkeljet-dhe-fuqia-e-driton-muharremit-ne-sistemin-prokurorial-te-kosoves/>). (Qasur për herë të fundit më 15 maj 2022).

³⁵ “Ekskluzive: Driton Muharremi jep dorëheqje nga pozita e anëtarit në KGJK”, Betimi për Drejtësi, 6 gusht 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-driton-muharremi-jep-doreheqje-nga-pozita-e-anetarit-ne-kgjk/>). (Qasur për herë të fundit më 17 maj 2022).

Përgjithshëm,³⁶ masë kjo e cila ishte vërtetuar edhe nga Supremja.³⁷ Katër ditë më vonë, Muharremi ka dhënë dorëheqje me shkrim nga pozita e gjyqtarit, duke shprehur pakënaqësinë me vendimin për transferimin e tij.

Pa dyshim se skandale të tilla minojnë dhe zbehin përpjekjet për të ndërtuar një gjyqësor të pavarur, profesional, me integritet e të paanshëm. Megjithatë, reagimi i Këshillit dhe sanksioni disiplinor i shqiptuar ndaj ish-gjyqtarit Muharremi, jep një sinjal pozitiv se ky institucion disponon me mekanizma efikas të llogaridhënies me të cilat mund të mbajë përgjegjës gjyqtarët që përfshihen në afera të caktuara. Po ashtu, fakti se subjekt i kësaj procedure ka qenë një ish-anëtar i saj, i cili edhe është gjetur përgjegjës për shkelje të tilla, dëshmon hapa konkret drejt luftimit të kulturës së pandëshkueshmërisë.

11. (Mos) Disiplinimi i gjykatësve dhe stafit serb që bojkotuan punën në GjTh në Mitrovicë

Gjykatësit dhe punonjësit mbështetës nga komuniteti serb në Gjykatën Themelore të Mitrovicës më 25 gusht 2021 kishin bojkotuar vendin e tyre të punës. Shkak për këtë bojkot ishte bërë vërtetimi i dënimit prej dy vite burgim efektiv ndaj ish-deputetit Ivan Todosijeviq, për deklaratat që i kishte bërë në lidhje me shqiptarët dhe masakrën e Reçakut. Gjykatësit dhe stafi mbështetës serb pretendonin se me gjykimin e këtij rasti nga një trup gjykues të përbërë nga tre gjykatës shqiptarë ishte shkelur Marrëveshja e Brukselit.³⁸

IKD përmes një reagimi ka vlerësuar se Departamenti Special i GjA ka vepruar drejt kur në kolegji të rregullt e ka gjykuar rastin e Ivan Todosijeviq. Sipas IKD-së, Marrëveshja për Normalizimin e Marrëdhënieve, Rregullorja e KGJK-së dhe praktika gjyqësore dëshmojnë se Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë nuk ka pasur kompetencë në rastin konkret.³⁹

Veprime të këtilla bien në kundërshtim me Ligjin nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve, konkretisht me nenin 5 par.2, nën par. 2.15 dhe nën par. 2.16 të këtij neni. Sipas këtyre dispozitave, gjykatësit nuk duhet të përfshihen në sjellje, qoftë në detyrë apo privatisht, që dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë e gjyqësorit apo edhe të angazhohen në aktivitete politike. Krahas kësaj, bojkotimi i punës së gjykatësve përbën dhe shkelje të obligimeve të përcaktuara me Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtarë, siç janë ushtrimi i funksionit në mënyrë efikase dhe të ligjshme, përmbajtja nga çfarëdo sjellje që mund të nxitë dyshimin në të qenurit apolitik,

³⁶ Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Vendimi **KGJK.nr.346/2021**, i datës 15 nëntor 2021. (Shih linkun https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/55050_KGJK_Vendimi_Nr_346_2021.pdf). Qasur për herë të fundit më 14 maj 2022).

³⁷ Gjykata Supreme e Kosovës. Aktgjykimi me nr. të rastit **AA.nr.85/2021** i nxjerrë më 20.12.2021. (Shih linkun https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/73313_SUP_AA%20_85_2021_SQ.pdf). (Qasur për herë të fundit më 13 maj 2022).

³⁸ Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve. 19.04.2013. (Shih linkun https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Marreveshja_e_Pare_per_Normalizimin_e_Marredhenieve_19_prill_2013.pdf?fbclid=IwAR1T7AYYmVXWcy9etmAkvwMs4SglajrMaUgeQhU86otWyYYhIJGyJkebRY). (Qasur për herë të fundit më 18 maj 2022).

³⁹ “IKD: Gjykata e Apelit ka vepruar drejt kur ka trajtuar rastin e Ivan Todosijeviq”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2021. (Shih linkun <https://kli-ks.org/ikd-gjykata-e-apelit-ka-vepruar-drejt-kur-ka-trajtuar-rastin-e-ivan-todosijeviq/>). (Qasur për herë të fundit më 17 maj 2022).

promovimi i standardeve të larta të sjelljes gjyqësore, të mos marrë pjesë në tubime apo manifestime politike etj.⁴⁰ Ndalesa të kësaj natyre mbi sjelljen e gjykatësve janë të përcaktuara edhe me nenin 41 të Ligjit për Gjykatat.⁴¹

Lidhur me këtë situatë të krijuar ka pasur dy reagime nga KGJK, i pari më 25 gusht 2021, me të cilin ky institucion njoftonte se po e trajton me seriozitet çështjen e bojkotit dhe se shpreson që së shpejti të njëjtit do të rikthehen në procesin e punës. Ndërsa, kumtesa e dytë e KGJK ishte ajo e 26 gushtit⁴², ku Këshilli njoftonte se gjykatësit dhe stafi mbështetës serb janë rikthyer në punë. Krahas këtyre reagimeve, ndaj këtyre gjykatësve që nuk janë paraqitur në vendet e tyre të punës nuk është iniciuar procedurë disiplinore e as nuk rezulton të jetë shqiptuar ndonjë sanksion disiplinor.

12. Risitë në KGJK pas zgjedhjes së kryesuesit të ri

Me zgjedhjen e kryesuesit të ri në korrik të vitit 2021 IKD ka gjetur se kanë ndryshuar edhe dinamikat në KGJK, pasi që janë ndërmarrë një sërë hapash pozitiv në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së gjyqësorit. Për këtë qëllim, për t'u vlerësuar lartë është vendimi i marrë për transmetimin e mbledhjeve të KGJK-së në rrjetin social *Facebook*, pastaj vendimi për raportimin e kryetarëve të gjykatave drejtpërdrejt në mbledhje të rregullta.⁴³

Në tetor 2021, KGJK ka miratuar Planin strategjik për vitin 2022-2024.⁴⁴ Ky plan ndër të tjera parasheh reduktimin e lëndëve të korrupsionit, krimin të organizuar dhe përfundimin e çështjeve sipas afateve të përcaktuara me standardet ndërkombëtare. Vendim tjetër mjaft i rëndësishëm i marrë nga udhëheqja e re e KGJK-së ka qenë ai për publikimin e vendimeve të Autoriteteve Kompetente për refuzimin e ankesave disiplinore të parashtruara nga personat fizik dhe juridik ndaj gjyqtarëve. Një nga projektet më të mëdha të gjyqësorit të cilit i është dhënë “drita e gjelbër” për t'u implementuar nga Këshilli është projekti i Byrosë Ndërkombëtare për Çështje të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL), për audio dhe video incizimin e seancave gjyqësore.⁴⁵

Iniciativa pozitive janë edhe ato për themelimin e grupeve punuese për hartimin e Protokollit mbi referimin e rasteve civile në procedurën e ndërmjetësimit nga gjykatat, për dizajnimin dhe

⁴⁰ Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarë. Pika 1.2, 1.4, 2.2.3 (b), 5.2, 5.5.

⁴¹ Ligji nr. 06/L - 054 për gjykatat. Neni 41.1 “Gjyqtarët nuk kryejnë asnjë detyrë apo shërbim që mundet të perceptohet si ndërhyrje në pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre, apo që përndryshe nuk është në përputhje me detyrat e një gjyqtari, apo dispozite të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë në Kosovë”. Neni 41.2 “Gjyqtarët nuk janë pjesëtarë të një subjekti politik dhe as nuk mund të marrin pjesë në çfarëdo lloj veprimtarie politike. Gjyqtari nuk do të kandidojë, mbajë, as ushtrojë ndonjë funksion politik”.

⁴² “Gjyqtarët dhe punonjësit mbështetës i kthehen punës në Gjykatën e Mitrovicës”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjyqtaret-dhe-punonjesit-mbeshtetes-i-kthehen-punes-ne-gjykatene-mitrovices/>). (Qasur për herë të fundit më 25 maj 2022).

⁴³ Shih vendimin **KGJK.nr.183/2021, KGJK.nr.184/2021**.

⁴⁴ “Plani strategjik 2022-2024, KGJK synon reduktimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe evitimin e zvarritjes së tyre”. Betimi për Drejtësi. 26 tetor 2021 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/plani-strategjik-2022-2024-kgjk-synon-reduktimin-e-lendeve-te-korrupsionit-dhe-krimin-te-organizuar-si-dhe-evitimin-e-zvarritjes-se-tyre/>) (Qasur për herë të fundit më 17 maj 2022).

⁴⁵ “INL financon projektin për audio-incizimin e seancave gjyqësore, KGJK i jep mbështetje”. Betimi për Drejtësi. 7 tetor 2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/inl-financon-projektin-per-audio-incizimin-e-seancave-gjyqesore-kgjk-i-jep-mbeshtetje/>). (Qasur për herë të fundit më 25 maj 2022).

hartimin e dërgesave postare dhe atij për standardizimin e formave të aktgjykimeve dhe vendimeve gjyqësore, hartimi i strategjisë për zvogëlimin e lëndëve të vjetra, forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile nëpërmjet takimeve të përbashkëta, vlerësimi i shërbimeve të postës dhe shpërndarësve në gjykata, çështja e shpërndarjes jo proporcionale dhe preferenciale të stafit nëpër gjykata, caktimi i një zyrtari përgjegjës brenda këshillit i cili do të pranojë të gjitha shqetësimet nga të gjitha gjykatat etj.⁴⁶

Gjykatave të Republikës së Kosovës shumë shpejt pritet tu bashkohen edhe 49 gjyqtarë të rinj⁴⁷, të cilët kanë kaluar me sukses të gjitha fazat e rekrutimit, në një proces të drejtë, transparent e të monitoruar nga shoqëria civile.

IKD inkurajon Këshillin që një praktikë e tillë e zhvillimit të procedurave rekrutuese në afate rekorde dhe e përcjellë me një transparencë të plotë të vazhdohet edhe në konkurset e tjera me qëllim që të plotësohen pozitat vakante në sistemin gjyqësor në një afat kohor të arsyeshëm. Krahasuar me konkursin e kaluar të shpallur më 31 dhjetor 2018, i cili kishte zgjatur më shumë se dy vjet, ky proces rekrutues ishte përfunduar brenda pesë muajve. Rekrutimi për të shërbyer në sistemin e drejtësisë ka qenë një “vrimë e zezë”, e kritikuar në vazhdimësi nga media e shoqëria civile për mungesë transparence dhe meritokracie, andaj janë për t’u vlerësuar përpjekjet dhe vullneti i përbërjes aktuale të Këshillit që të ndryshoj këtë qasje, çka do të ndikoj në rritjen e besimit të publikut në punën e këtij institucioni si dhe që të nxiten kuadro të reja e të suksesshme për tu bërë pjesë e një gare transparente e meritore.⁴⁸

⁴⁶ Shih vendimet: <https://www.gjyqesori-rks.org/vendimet-e-keshillit/?r=M&cYear=2021>

⁴⁷ “Këta janë 49 kandidatët që kaluan provimin për gjyqtarë (DOKUMENT)”. Betimi për Drejtësi, 8 prill 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/fillon-faza-e-intervistimit-per-80-kandidatet-per-gjyqtare-te-rinj/>). (Qasur për herë të fundit më 22 maj 2022).

⁴⁸ “Si ka rrjedhur procesi i rekrutimit të 49 gjykatësve të rinj?”. Betimi për Drejtësi, 17 maj 2022 (Shih linkun https://betimiperdrejtesi.com/si-ka-rrjedhur-procesi-i-rekrutimit-te-49-gjyqatesve-te-rinj/?fbclid=IwAR0OcHcG_iwPvgxm5IT52GnuRs6TEX_08wLMF7q21T1LOmF-Wnk-VSCa69Y). (Qasur për herë të fundit më 23 maj 2022).

Këshilli Prokurorial i Kosovës



13. Miratimi i legjislacionit sekondar nga KPK

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) gjatë vitit 2021 nuk ka treguar efikasitet të lartë në miratimin e akteve sekondare në krahasim me vitin paraprak⁴⁹, pasi gjatë kësaj periudhe ka miratuar vetëm tri rregullore, një plotësim të UA si dhe tre udhëzues.⁵⁰ Një fenomen negativ që e ka shoqëruar KPK-në edhe gjatë vitit 2021 ka qenë dështimi për të miratuar aktet nënligjore të përcaktuara me Planin e saj të Punës për këtë vit, si aktet normative për strukturën organizative dhe funksionimin e administratës së sistemit prokurorial dhe udhëzuesin për zbatimin e rregullores për vlerësim të performancës të prokurorëve. KPK nuk ka arritur që të miratojë as aktet nënligjore që rrjedhin sipas ligjit të ri për KPK-në, ndonëse kanë kaluar afro dy vite nga hyrja në fuqi e këtij ligji.⁵¹

Mos zbatimin e këtyre obligimeve ligjore KPK e ka arsyetuar me faktin se janë në fuqi rregullore që rregullojnë çështjet e lartcekura. KPK ka njoftuar se së shpejti pritet që të miratohet Rregullorja për strukturën organizative dhe funksionimin e SKPK, me një organizim të ri të Sekretariatit.⁵² Në lidhje me këtë qëndrim të KPK-së, duhet theksuar se rregulloret që i citon KPK janë akte nënligjore që para së gjithash janë nxjerrë në bazë të një ligji tashmë të shfuqizuar. Pra, kjo bazë ligjore tanimë nuk ekziston. Rregulloret që përmend Këshilli duhet të zbatohen vetëm deri në momentin e miratimit të akteve të tjera, të cilat sipas ligjit duhet të miratohen brenda gjashtë muajve që nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 06/1-056 për KPK.⁵³

IKD rithekson se një ndër obligimet primare të KPK-së është miratimi i akteve nënligjore, andaj çfarëdo dështimi në këtë drejtim, përbën mos ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor që ka ky institucion. KPK duhet të ketë parasysh se mungesa e secilës rregullore, paraqet zbrazëti juridike, pengesë në administrimin e duhur të sistemit prokurorial dhe një planifikim të mangët. Me këtë mënyrë jo efikase të veprimit, rrezikohet që të përsëritet praktika negative e deritashme ku ligjet që kanë obliguar KPK-në do të shfuqizoheshin, derisa obligimet që kanë rrjedhur nga to do të mbesin të pazbatuara nga ky institucion.

14. Llogaridhënia dhe integriteti në Sistemin Prokurorial

Përqindja absolute e vendimmarrjes në Këshill gjatë vitit 2021 ka qenë lirimi i prokurorëve nga përgjegjësia disiplinore, derisa masa më e rëndë që KPK ka shqiptuar ka qenë vërejtja jo

⁴⁹ Bajraktari, L. Gashi, L: “Cenimi i integritetit të Këshillave nga Këshillat”. Prishtinë. Prill 2021. Fq.36-39.

⁵⁰ Rregullore Nr.01/2021, Nr.02/2021 dhe Nr.03/2021. UA nr.01/2021. Udhëzues për Qasjen e Avokatëve në objektet e sistemit prokurorial, Udhëzuesi dhe manuali për komunikim në kriza të sistemit prokurorial, Udhëzuesi themelor i referimit i procedurave disiplinore nga Autoritetet Kompetente dhe Panelet Hetimore në sistemin prokurorial.

⁵¹ **Shënim:** Ligji për KPK i cili ka hyrë në fuqi më 18 prill 2019 kishte përcaktuar shprehimisht nxjerrjen e një numri të caktuar të rregulloresh brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi si: Rregulloren për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisioneve të Përhershme për KPK-në, Rregulloren për Procesin e Emërimit dhe Riemërimit të Prokurorëve nga Komitetet e nën-përfaqësuar në mesin e prokurorëve që shërbejnë në Kosovë dhe Rregullore për Strukturën Organizative dhe Funksionimin e SKPK-së.

⁵² Përgjigje nga KPK për IKD. 25 janar 2022.

⁵³ Ligji nr. 06/1-056 për KPK. Neni 37.1 “Aktet nënligjore të përcaktuara në këtë ligj do të nxirren në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”

publike me shkrim, çka paraqet një qasje “*amnistuese*” të Këshillit në disiplinimin e prokurorëve që përfshihen në shkelje disiplinore.⁵⁴

Në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore duhet theksuar se KPK dhe Prokurori i Shtetit (PSH) kanë miratuar raportet vjetore të punës për vitin 2020 dhe të njëjtat edhe i kanë publikuar në faqen zyrtare. Mirëpo, ashtu siç ka ndodhur në vitet e kaluara, edhe për këtë vit këto raporte përmbajnë vetëm të dhëna të shumta statistikore, por që nuk ndërtojnë një analizë konkrete lidhur me këto të dhëna statistikore. Për dallim nga viti 2020, KPK gjatë kësaj periudhe kishte përfunduar me sukses procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve.

KPK ka dështuar që të ftojë kryeprokurorët për të raportuar para anëtarëve të saj. KPK këtë e ka arsyetuar me faktin se ky raportim nuk ka qenë i përshtatshëm shkak i pandemisë Covid/19 dhe të njëjtit vetëm kanë dorëzuar raportet me shkrim para anëtarëve të KPK-së.⁵⁵ IKD vlerëson se ky arsyetim nuk e mbulon dështimin e KPK-së në këtë rast për të përmbushur këtë obligim, marrë parasysh se shumica e mbledhjeve të KPK-së janë organizuar në mënyrë virtuale përmes platformës “Zoom”, dhe ashtu siç kanë marrë pjesë anëtarët e KPK-së, mediat dhe shoqëria civile, në atë mënyrë do të mund të raportonin edhe kryeprokurorët e prokurorive përkatëse. Për më tepër, mos prezenca e kryeprokurorëve gjatë prezantimit të raporteve të punës i ka pamundësuar anëtarëve të KPK-së që të kërkojnë sqarime shtesë apo të marrin përgjigje nga të njëjtit për të dhëna të caktuara që i përmbajnë ato plane pune.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se është e domosdoshme që miratimi i këtyre planeve të punës të mos shndërrohet vetëm në përmbushje formale të obligimeve, por që t’i mundësojë publikut të gjerë që të mirë informohet për punën dhe sfidat reale të sistemit prokurorial, duke ndikuar që të rritet edhe llogaridhënia dhe transparenca brenda vet këtij institucioni.

15. Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit prokurorial

KPK në vazhdimësi proklamon ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun dhe mediat. KPK ka miratuar rregullore⁵⁶ dhe strategji⁵⁷ për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të lehtësuar bashkëpunimin me publikun dhe median. Po ashtu, edhe në Raportin e Planit të Punës për vitin 2021, KPK ka përcaktuar një planifikim për transparencën dhe komunikimin me publikun dhe mediat.⁵⁸ Megjithatë, nga 241 kërkesa për qasje në informata dhe dokumente publike të adresuara në sistemin prokurorial, IKD ka pranuar 95 përgjigje pozitive (39%), 12 përgjigje negative (5%), ndërsa 134 sosh (56%) kanë mbetur pa përgjigje.

⁵⁴ “*Raporti i punës për vitin 2021 për KPK-në*”. Prishtinë. Mars 2022. Fq. 29-30.


⁵⁵ Përgjigje nga KPK për IKD. 28 mars 2022.

⁵⁶ Rregullore nr.03/2019 për Shërbimin e Komunikimit publik në sistemin prokurorial.

⁵⁷ Strategjia për Komunikim e sistemit prokurorial 2021-2023.

⁵⁸ “*Plani vjetor i Punës 2021 i Këshillit Prokurorial të Kosovës*”. Fq.19. (Shih linkun <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Plane%20te%20Punes/PLANI%20VJETOR%20I%20PUN%20C3%8BS%20I%20VITIT%202021%20I%20K%20C3%8BSHILLIT%20PROKURORIAL%20C3%8B%20KOSOV%20C3%8BS.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 18 maj 2022).

Vetëm në KPK, IKD gjatë kësaj periudhe ka parashtruar 60 kërkesa të tilla, nga të cilat, në 23 raste (38%) ka pranuar përgjigje pozitive, në 5 raste (8%) ka pranuar përgjigje negative, ndërsa në 32 kërkesa tjera (53%), KPK nuk ishte përgjigjur fare.



Grafiku 2: Transparenca e KPK-së dhe prokurorive në kërkesat e IKD-së gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021 KPK ka nxjerrë afro 200 vendime⁵⁹, nga të cilat vetëm 103 vendime (51.5%) janë publikuar edhe në faqen e KPK-së, ndërsa nuk ka publikuar 97 vendime (48.5%).⁶⁰ Mos publikimi i rreth gjysmës së vendimeve të KPK-së paraqet mospërfillje dhe moszbatim të akteve që vet Këshilli i ka miratuar.⁶¹ Po ashtu, KPK-ja ka vazhduar me mos publikimin e vendimeve në gjuhën serbe pasi nga afro 200 vendimet e miratuara, vetëm 45 vendime janë publikuar në gjuhën serbe, ndërsa nga tre (3) rregulloret e miratuara, në gjuhën serbe janë publikuar dy (2) prej tyre.

Me këtë rast, IKD i rikujton KPK-së se dy (2) gjuhësia është parim kushtetues, i cili duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet publike. Për më tepër, në kuadër të sistemit prokurorial janë të angazhuar edhe prokurorë serbë e sipas raportit të PSH janë 14 ose 7,69% prokurorë nga ky komunitet, prej tyre edhe anëtarë në KPK.

Mungesë të transparencës në raport me publikun KPK kishte treguar me rastin e mbajtjes së takimit të jashtëzakonshëm (Takimi 194 i KPK-së), ku i njëjti nuk është përfshirë fare në kalendarin e takimeve dhe nuk është bërë publik rendi i ditës, por vetëm është lëshuar një komunikatë për media pas përfundimit të atij takimi. Në rrethana të tilla, është pamundësuar monitorimi i këtij takimi të KPK-së nga ana e publikut, mediave dhe shoqërisë civile.

Edhe injorimi që KPK dhe PSH i kishin bërë ofertës së Ambasadës Britanike për mbështetje të procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit, ka dëshmuar se ky institucion krahas promovimit të transparencës, nuk e zbaton atë në praktikë. Ky injorim i bërë ndaj një partneri të rëndësishëm siç është Ambasada e Britanisë pa dyshim se përçon një mesazh negativ tek

⁵⁹ Përgjigje nga KPK për IKD. 28 mars 2022.

⁶⁰ **Shënim:** Të dhënat e fundit lidhur me publikimin e vendimeve janë nxjerrë më 10 prill 2022.

⁶¹ Rregullorja nr.02/2020 për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së. Neni 16.2 “Shpallja e vendimeve të Këshillit bëhet pa vonesë pas përfundimit të mbledhjes dhe publikohen në faqen zyrtare të Këshillit, përveç nëse ligji parasheh ndryshe”.

opinionii publik dhe dëmton rëndë kredibilitetin e njërit ndër proceseve më të rëndësishme në sistemin prokurorial, siç është ai i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit.⁶²

16. (Pa)ligjshmëria në avancimet dhe transferimet e prokurorëve

KPK edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar praktikën e avancimit të prokurorëve pa konkurs, në emër të transferimit. Ndonëse, transferimi dhe avancimi i prokurorëve rregullohet me Kushtetutë, ligj dhe akt normativ të veçantë, KPK dhe Kryeprokurori i Shtetit nuk i kanë përfillur këto rregulla.

Vendimi i nxjerrë nga ish-Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi për transferimin e prokurorit Bahri Hyseni nga PTh në Ferizaj në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit ishte marrë në shpërfillje të plotë me dispozitat ligjore si dhe nevojat e ZKPSH-së. Në këtë rast, Hyseni ka kaluar në ZKPSH me një vendim të Kryeprokurorit të Shtetit, është avancuar pa konkurs në ZKPSH, nga niveli më i ulët brenda sistemit prokurorial në një nivel më të lartë, pa asnjë nevojë të jashtëzakonshme, në kundërshtim me rregullat në fuqi.⁶³ KPK jo vetëm që nuk e kishte korrigjuar këtë praktikë të kundërligjshme, por në maj të vitit 2021, kishte marrë vendim që të “noterizojë” vendimin për avancim të Hysenit në ZKPSH.⁶⁴

Po ashtu, vendimi i KPK për transferimin e prokurorit Fatmir Behrami nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të Mitur të PTh në Prishtinë ishte i kundërligjshëm. Kalimi i një prokurori nga DP në DKR ose DM nuk mund të konsiderohet transferim, por avancim.⁶⁵ Kundërligjshëm ishte nxjerrë edhe vendimi i ish-Kryeprokurorit Lumezi për transferimin e prokurores Mone Sylja nga DP në DM të PTH në Gjakovë. Kjo prokurore ishte transferuar për një afat 6 mujor, ndonëse sipas nenit 7.2 të Rregullores nr.03/2016 ky afat nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 ditë, përveç nëse KPK miraton një periudhë më të gjatë. Po ashtu, edhe KPK kishte konstatuar se prokurorja Sylja, e cila kishte aplikuar si kandidate e vetme për plotësimin e një pozite në këtë departament, nuk i plotësonte kriteret për avancim.⁶⁶

Pa bazë ligjore ka qenë edhe vendimi i nxjerrë nga KPK për vazhdimin e transferimit të përkohshëm të prokurorit Bogdan Spadijer në DP të PTh në Mitrovicë. Prokurori Spadijer më 21 shkurt 2020 ishte transferuar përkohësisht për periudhën një vjeçare, ndërsa më 8 shkurt 2021 ky transferim i ishte vazhduar deri në një vendim të ri të Këshillit. Vazhdimi i transferimit ishte bërë në kundërshtim me Ligjin për KPK, ligj ky i cili në nenin 28.1 ka përcaktuar që

⁶² “Ekskluzive (dokument): Si Maloku dhe Lumezi injoruan për dy muaj ofertën e Ambasadës Britanike për mbështetje të procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit?”, Betimi për Drejtësi, 25 janar 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-dokument-si-maloku-dhe-lumezi-injoruan-per-dy-muaj-oferten-e-ambasades-britanike-per-mbeshtetje-te-procesit-te-zgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 19 maj 2022).

⁶³ Bajraktari, L: “Ligjshmëria e avancimeve dhe përfitimeve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit”. Prishtinë. Shkurt 2021. Fq.14-17.

⁶⁴ Vendimi KPK.nr.323/2021 i nxjerrë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

⁶⁵ Bajraktari, L: “Ligjshmëria e avancimeve dhe përfitimeve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit”. Fq.16.

⁶⁶ “KPK miraton Rregulloren për transferim dhe avancim të prokurorëve, themelohen edhe dy panele hetimore”, Betimi për Drejtësi. 2 nëntor 2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-miraton-rregulloren-per-transferim-dhe-avancim-te-prokuroreve-themelohen-edhe-dy-panelet-hetimore/>). (Qasur për herë të fundit më 19 maj 2022).

Këshilli mund të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër për një periudhë kohore jo më të gjatë se një vit.

IKD në vazhdimësi kishte rekomanduar që KPK duhet të ndalë praktikën negative dhe të paligjshme të avancimit të prokurorëve në emër të transferimit të përkohshëm. Qartësimi i dallimit në mes avancimit dhe transferimit ka qenë rekomandim për KPK-në edhe në raportet e kaluara të IKD-së. Si rikujtim, IKD gjen se kalimi i një prokurori nga DP në DKR ose DM nuk mund të konsiderohet transferim, por avancim. Dallimi dhe kriteret për avancim dhe transferim parashihen edhe me Rregulloren e re të KPK-së për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të Shtetit.

17. Zgjedhjet dhe kandidaturat e kundërligjshme në KPK

KPK që nga data 18 janar 2021 udhëhiqet nga Jetish Maloku, i cili është zgjedhur në mënyrë të kundërligjshme në këtë pozitë.⁶⁷ Pozitën e anëtarit në KPK, Jetishi e ka mbajtur gjatë viteve 2011-2015. Ligji për KPK-në i cili aktualisht është në fuqi ka përcaktuar qartë se anëtarët e Këshillit qëndrojnë në detyrë për një mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Ky përcaktim i dhënë në këtë dispozitë pamundëson dhe ndalon që anëtarë të KPK të rizgjidhen kandidatët që paraprakisht kanë ushtruar këtë funksion.⁶⁸

E kundërligjshme ka qenë edhe kandidatura e ish-anëtares së KPK-së Dëshirë Jusaj për Kryeprokurore të PTh në Gjakovë. Jusaj ka qenë anëtare e KPK-së deri më 21 tetor 2020, kur pak para përfundimit të mandatit të rregullt të saj, ajo kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë për të kandiduar më pas si kryeprokurore.⁶⁹ Një praktikë e tillë ishte vlerësuar se paraqet “mungesë të integritetit, politikë të rrezikshme për sistemin prokurorial dhe dëshmi për kapjen e sistemit prokurorial nga një numër i vogël i prokurorëve”.⁷⁰ Një kandidim apo një zgjedhje e tillë do të paraqiste konflikt të interesit sipas nenit 18.1.1.1 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.⁷¹ Kjo më së mirë është dëshmuar edhe në rastin e kandidimit të ish-anëtarit të KPK-së Arben Ismajli për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, pasi që sipas opinionit të Agjencisë Kundër Korrupsion të datës 4 mars 2022, është konstatuar se emërimi eventual i ish-anëtarëve të KPK-së në pozitën e

⁶⁷ “Prokurori Jetish Maloku zgjedhet kryesues i KPK-së”. *Betimi për Drejtësi*. 18 janar 2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-jetish-maloku-zgjedhet-kryesues-i-kpk-se/>). (Qasur për herë të fundit më 13 prill 2022).

⁶⁸ “IKD: KPK në mënyrë të kundërligjshme nominoi për anëtar të KPK-së, ish-anëtarin Jetish Maloku”. *Betimi për Drejtësi*. 21 tetor 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ikd-kpk-ne-menyre-te-kunderligjshme-nominoi-per-anetar-te-kpk-se-ish-anetarin-jetish-maloku/>). (Qasur për herë të fundit më 2 maj 2022).

⁶⁹ “IKD: Dorëheqja e anëtarëve të KPK-së në kohën para shpalljes së konkursit për kryeprokurorë, praktikë që mund të paraqesë konflikt të interesit dhe mungesë të integritetit”. *Betimi për Drejtësi*. 8 tetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ikd-doreheqja-e-anetareve-te-kpk-se-ne-kohen-para-shpalljes-se-konkursit-per-kryeprokurore-praktike-qe-mund-te-paraqese-konflikt-te-interesit-dhe-mungese-te-integritetit/>). (Qasur për herë të fundit më 13 maj 2022).

⁷⁰ Bajraktari, L. Gashi, L. “*Cenimi i integritetit të Këshillave nga Këshillat*”. Prishtinë. Prill 2021. Fq.45

⁷¹ Ligji Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Neni 18.1.1.1 “*Të punësohet ose të emërohet, për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre;*”.

Kryeprokurorit të Shtetit pa kaluar afati dy vjeçar nga përfundimi i mandatit në KPK, bie ndesh me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit. Në këtë rast, ish-kandidati Ismajli, nëse do të zgjidhej në këtë pozitë, do të ishte në konflikt të interesit.⁷²

18. Vendimi skandaloz i KPK-së për trajnimin e prokurores tre muaj para pensionimit

Me një vendim skandaloz të KPK-së, tre muaj para pensionimit, ish-prokuroerja Ferdane Sylejmani ishte detyruar të ndjekë trajnime për shkak të performancës së saj të pamjaftueshme në PTh në Prishtinë.⁷³ Një vendim i tillë i Këshillit që të trajnojë prokurorë, të cilët dalin në pension përveç që është skandaloz po ashtu është edhe i padobishëm për vet sistemin prokurorial, pasi me daljen në pension të prokurores Sylejmani, KPK nuk mund të përfitojë asnjë dobi profesionale nga kjo prokurore.

IKD konsideron se KPK me një vendim të tillë ka keqpërdorur resurset e shtetit duke shpenzuar buxhet në një punë e cila nuk i sjell asnjë dobi sistemit prokurorial dhe e gjithë kjo si pasojë e keq menaxhimit të kompetencave dhe keq planifikimit të politikave të KPK-së. Andaj, një vendim i tillë i KPK-së është i palogjikshëm dhe bie në kundërshtim të plotë me qëllimin e trajnimit dhe me efektet për çka edhe bëhet vlerësimi i performancës. Duke u bazuar në nenin 30 par 2, të Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, KPK ka mundur të mos e marrë një vendim të tillë, pasi paragrafi 2 i këtij neni i'a lejon KPK-së një lloj diskrecioni sa i përket vendimeve në rast se prokurori merr vlerësimin "i pamjaftueshëm", ku shprehimisht thuhet se "Këshilli "mund" të marrë vendimet në vijim"...⁷⁴

Ndryshe, Sylejmani më 19 prill 2022 ka arritur moshën e pensionimit dhe kontributi i saj lidhur me njohuritë e fituara nga ndjekja e trajnimeve për sistemin prokurorial do jetë i padobishëm pasi e njëjta nuk do të jetë më pjesë e këtij sistemi. Mirëpo, kjo nuk është hera e parë që prokuroerja Ferdane Sylejmani është përballur me masa dhe degradim. Pas raportimit të "Betimi për Drejtësi", në vitin 2019, ajo ishte degraduar nga Këshilli Prokurorial nga Departamenti i Krimeve të Rënda në Departamentin e Përgjithshëm.⁷⁵

19. Skandali i përgjimeve dhe standardet e dyfishta të KPK

19.1 Dorëheqja e prokurores së përfshirë në përgjime

Gjatë vitit 2021 opinionioni publik ishte tronditur me publikimin e disa përgjimeve ku përfshiheshin akterë të sistemit të drejtësisë në biseda të paautorizuara. Ish-prokuroerja e PTh në Prishtinë Shemsije Asllani ishte përfshirë në biseda telefonike me një telefonues, duke i

⁷² "Kush janë kandidatët që kanë konflikt të interesit në garën për Kryeprokuror të Shtetit?". Betimi për Drejtësi. 12 mars 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kush-jane-kandidatet-qe-kane-konflikt-te-interesit-ne-garen-per-kryeprokuror-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 25 maj 2022).

⁷³ "Betimi për Drejtësi 263: Vendimi skandaloz i Këshillit Prokurorial". Betimi për Drejtësi, 22 janar 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-263-vendimi-skandaloz-i-keshillit-prokurorial/?fbclid=IëAR2IëUKo42AxrNnG8ZZ6SEVzunameNM9aFahLLvEë-5jroyS5KN793odLK0>). (Qasur për herë të fundit më 19 maj 2022).

⁷⁴ Për më tepër Shih Rregulloren Nr.05.2020 për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.

⁷⁵ "Pas raportimit të "Betimi për Drejtësi", degradohet prokuroerja Ferdane Sylejmani". Betimi për Drejtësi. 9 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-raportimit-te-betimi-per-drejtesi-degradohet-prokurorja-ferdane-sylejmani/>). (Qasur për herë të fundit më 14 prill 2022).

premtuar këtij të fundit se do ta përdorë ndikimin e saj për të ndërhyrë edhe në rastin ku ai pretendonte se padrejtësisht i ishte ndaluar një veturë e kushtueshme.⁷⁶ Pas inicimit të procedurës disiplinore ndaj saj, kjo e fundit ishte gjetur përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe ndaj saj ishte shqiptuar si sanksion disiplinor “*Transferimi i përhershëm në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, në Departamentin e Përgjithshëm*”,⁷⁷ vendim ky i cili ishte vërtetuar edhe nga Supremja. Si rezultat i kësaj, prokurorja Asllani kishte dhënë dorëheqje të përvokueshme nga kjo pozitë.

Përfshirja në sjellje të tilla të pahijshme e një prokurori zbeh besimin e publikut në punën e tërë sistemit prokurorial, përderisa këta të fundit janë të thirrur dhe kanë mandat ligjor që të hetojnë dhe ndjekin kryerësit e veprave penale, e assesi të bëhen pjesë e këtyre veprimtarive jo ligjore. Megjithatë, reagimi i Këshillit dhe sanksioni disiplinor i shqiptuar ndaj ish-prokurores Asllani jep një sinjal pozitiv mbi funksionimin e mekanizmave të brendshëm. Por, qasja selektive e këtyre mekanizmave, është një problematikë e veçantë e këtyre mekanizmave, për të cilën do të flasim në vijim të këtij raporti.

19.2 Përfshirja e Lumezit në skandalin e përgjimeve dhe mos reagimi i KPK

Ndonëse emri i ish-kryeprokurorit Lumezi ishte apostrofuar në dy përgjime të publikuara në mediumin online “shqip.com”, KPK nuk ka iniciuar fare procedurë disiplinore ndaj këtij të fundit, për të zbardhur për publikun përfshirjen e tij në këtë aferë. Përmes një lidhje telefonike në një emision televiziv Lumezi konfirmoi se kishte biseduar me biznesmenin Halit Sahitaj, me të cilin e kishte vënë në kontakt ish-gjyqtari Driton Muharremi dhe i cili kishte kërkuar që të lirohet një veturë që atij i ishte konfiskuar. Siç ka deklaruar Lumezi, qëllimi i këtij personit ishte shantazhimi i tyre, e jo vetura për të cilën flitet në biseda.⁷⁸

Veprimet e kryeprokurorit Lumezi ndonëse janë pothuajse identike me ato të ish-prokurores Asllani, ato nuk janë konsideruar si bazë e mjaftueshme për të iniciuar procedurë hetimore disiplinore ndaj të parit të Prokurorit të Shtetit. Arsyetimi i dhënë nga ana e kryesuesit të KPK-së Jetish Maloku, për mos inicim të procedurës disiplinore ndaj Lumezit ishte se ky i fundit nuk ishte direkt i involvuar në përgjimet e publikuara dhe se kinse ai s’ka qenë pjesë e asaj që është thënë ato biseda të publikuara.⁷⁹

⁷⁶ “Ekskluzive: Ndërhyrje në raste, ushtrim i ndikimit, keqpërdorim i pozitës dhe fotografi të dyshimta – rasti me plot dritëhije i prokurores Shemsije Asllani”. Shqip.com. (Shih linkun <https://shqip.com/shenjester/ekskluzive-nderhyrje-ne-raste-ushtrim-i-ndikimit-keqperdorim-i-pozites-dhe-fotografi-te-dyshimta-rasti-me-plot-dritehije-i-prokurores-shemsije-asllani/>). (Qasur për herë të fundit më 17 maj 2022).

⁷⁷ “KPK degradon dhe transferon prokuroren Shemsije Asllani”, Betimi për Drejtësi, 1 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-degradon-dhe-transferon-prokuroren-shemsije-asllani/>). (Qasur për herë të fundit më 28 mars 2022).

⁷⁸ “Lumezi: Prokuroria Speciale do ta hetojë audio-incizimin e fundit”. Telegrafi.com. (Shih linkun <https://telegrafi.com/lumezi-prokuroria-speciale-ta-hetoje-audio-incizimin-e-fundit/>). (Qasur për herë të fundit më 13 prill 2022).

⁷⁹ “Maloku thotë se janë duke e rishqyrtuar vendimin KPMSHC për ish-drejtorin e Sekretariatit të KPK-së, Lavdim Krasniqi”, Betimi për Drejtësi, 30 dhjetor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/moloku-thote-se-jane-duke-e-rishqyrtuar-vendimin-kpmshc-per-ish-drejtorin-e-sekretariatit-te-kpk-se-lavdim-krasniqi/>). (Qasur për herë të fundit më 29 mars 2022).

Në mënyrë që të arrihej deri tek një përfundim i tillë, është dashur që së paku KPK “*ex officio*” të iniciojë hetim disiplinor, si Autoritet Kompetent, marrë parasysh faktin që Lumezi në cilësi të kryeprokurorit ka qenë anëtar i këtij këshilli. Me nenin 2.2 të Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale për anëtarët e Këshillit përcaktohet në mënyrë të qartë se “gjatë gjithë kohës anëtari i Këshillit do të veprojë në atë mënyrë që të nxisë besimin e publikut në dinjitetin, integritetin, efektivitetin dhe paanshmërinë e këshillit”.

20. Dështimi për ta përmbushur planin e punës për vitin 2021

KPK në janarin e vitit 2021, e kishte miratuar dhe publikuar planin e punës për vitin 2021. Megjithatë, shumë nga objektivat e përfshira në këtë plan të punës kanë mbetur vetëm planifikim në letër, të tilla si: formimi i një mekanizmi që trajton rastet e denigrimit të personalitetit të prokurorëve, miratimi i një sërë aktesh nënligjore, ndërmarrja e hapave për ofrimin e sigurimeve shëndetësore për prokurorë dhe stafin administrativ, raportimi i rregullt i kryeprokurorëve për çështjet e administrimit dhe efikasitetit në trajtimin e lëndëve, formimi i një mekanizmi këshillëdhënës për prokuror në zbatim të kodit të etikës dhe sjelljes profesionale.

Disa nga planifikimet e përfshira në këtë plan pune të realizuara nga KPK janë hartimi i planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, në fokus të të cilit është ndërlidhja e performancës së sistemit prokurorial me nevojat e qytetarëve,⁸⁰ miratimi i strategjisë për komunikim të sistemit prokurorial 2021-2023, themelimi i komisionit për vlerësim të performancës së prokurorëve, hartimi i dokumentit “Politikat e trajnimit për prokurorë dhe staf administrativ të sistemit prokurorial” dhe Planin e nevojave për trajnimin e prokurorëve dhe stafit administrativ” etj.⁸¹ Ndërkaq, sa i përket planifikimit për ngritje të transparencës KPK ndonëse ka arritur ta miratojë Strategjinë për Komunikim gjatë vitit të kaluar, nuk ka arritur që të zbatojë aktivitetet e tjera të planifikuara si organizimi i kampanjave informuese, pastaj mbajtjen e tryezave të diskutimit dhe takimeve të ndryshme me sektorin jo qeveritar.

KPK sërish ka përfshirë në planin e saj të punës planifikime të tjera por të cilat kanë qenë shumë abstrakte dhe si të tilla nuk kanë konkretizuar planifikim të mirë caktuar, siç janë për shembull: “*Avancimi i sistemit të rekrutimit të prokurorëve, përfshirë sistemin elektronik*”; “*Vlerësimi i vazhdueshëm i rrezikut për secilin proces kritik të punës*”; “*Zbatim efikas i sistemit të ri të vlerësimit të performancës*”; “*Planifikimi buxhetor i bazuar në nevoja dhe orientime strategjike*”; “*Avancimi i procesit të mbikëqyrjes dhe kontrollit*”; “*Standardizimi dhe unifikimi i informacionit të brendshëm dhe të jashtëm*”; apo “*Mbështetje në sigurimin e infrastrukturës nënligjore*”.⁸²

IKD i kujton KPK-së se planet vjetore të punës, ku përfshihen aktivitetet kryesore që pritet të realizohen përgjatë një viti, kanë një rëndësi jetike në planifikimin dhe avancimin e administrimit të mirë të drejtësisë, e assesi nuk janë dokumente formale. Andaj, IKD i rekomandon KPK-së që gjatë hartimit të planit vjetor të punës, të tregojë një vizion të qartë,

⁸⁰ Këshilli Prokurorial i Kosovës. “*Plani strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024*”. Fq.7.

⁸¹ “*Raporti i punës për vitin 2021 për KPK-në*”. Prishtinë. Mars 2022. Fq.24.

⁸² “*Plani vjetor i Punës 2021 i Këshillit Prokurorial të Kosovës*”. Fq.13,15-19,23.

duke vendosur objektiva dhe aktivitete të matshme dhe që tërë potencialin e saj t'ia kushtojë përmbushjes së këtij plani përgjatë një viti kalendarik, për arritjen e synimeve të kërkuara lidhur me ngritjen e kualitetit në administrimin e drejtësisë.